



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština-Assembly

Plani i Punës së Komisionit Ad-hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.

Komisioni Ad- hoc, për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social, i caktuar me Vendimin Nr. 06-V 316 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 02.02.2019, miraton këtë:

Plani i Punës

Anëtarët e Komisionit Ad hoc:

1. Dardan Sejdiu, nga GP i PSD, Kryetar,
2. Blerim Kuçi, nga GP i AAK, Zv/kryetar i parë,
3., nga GP i LS, Zv/kryetar/e i/e dytë,
4., nga GP i LDK-së, anëtar/e,
5., nga GP i LDK-së, anëtar/e,
6. Safet Hadërgjonaj, nga GP i PDK-së, anëtare,
7. Flora Brovina nga GP i PDK-së, anëtare
8., nga GP i LVV-së, anëtar/e,
9., nga GP i LVV-së, anëtar/e,
10. Enver Hoti, nga GP Nisma Socialdemokrate, anëtar dhe
11. Fikrim Damka, nga GP “6+” anëtar.

Mars, 2019

Afatet kohore	Aktivitetet	Lokacioni	Shënim	Personat përgjegjës
Faza e parë: TAKIMET ME PALËT E INTERESIT				
Java I (Mars)	Përgatitja e planit të punës së Komisionit Ad-hoc si dhe miratimi i këtij plani	Ndërtesa e Kuvendit	Kryetari i Komisionit Ad-Hoc si dhe stafi mbështetës përgatit draft Planin e Punës i cili miratohet në Komision	Komisioni Ad-hoc\ Stafi mbështetës
	Takimi me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica Takim me Bankën Botërorë.		Takim informues lidhur me draft koncept dokumentin lidhur me rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social. Prezantimi dhe diskutim lidhur me rregullimin e pensioneve.	Komisioni Stafi mbështetës
	Takimi me Ministrin e Financave, z. Bedri Hamza		Takim informues lidhur me ndikimin buxhetor të skemave personale dhe beneficioneve sociale.	Komisioni Stafi mbështetës
Java II (Prill)	Takim me përfaqësuesit e Shoqatave të pensionistëve.	Ndërtesa e Kuvendit	Komisioni njoftohet për gjendjen reale të pensionistëve, me sfidat dhe opinionin e tyre lidhur me temën për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.	Komisioni Stafi mbështetës
Java III (Prill)	Takim me Drejtorin e Departamentit të Pensioneve MPMS. Takim me Drejtorin e Departamentit të familjeve të dëshmoreve, Invalidëve të luftës.	Ndërtesa e Kuvendit	Komisioni njoftohet për gjendjen reale të përfituesve të skemave të pensioneve dhe atyre sociale me sfidat dhe opinionin e tyre lidhur me temën për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.	Komisioni Stafi mbështetës

	Takim me përfaqësuesit e skemave përfituese pensionale dhe sociale.			
Java IV (Prill)	Takim me Përfaqësuesit e BSPK-së	Ndërtesa e Kuvendit	Komisioni informohet në tërësi për gjendjen dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, me sfidat dhe opinionin e tyre lidhur me temën për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.	Komisioni Stafi mbështetës
Java V (Prill)	Takim me Përfaqësuesit e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-Trusti.	Ndërtesa e Kuvendit	Komisioni informohet në tërësi për balancet, tarifat për investime nga ky fond, përfitimet nga investimet etj.	Komisioni Stafi mbështetës
Java VI (Maj)	Takim me Banka Qendrore e Kosovës	Prishtinë	Komisioni diskuton me BQK lidhur ecurinë dhe mënyrën e rregullimit dhe menaxhimit të fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social në Republikën e Kosovës.	Komisioni Stafi mbështetës
Java VII (Maj)	Takim me Fondi Monetar Ndërkombëtar	Prishtinë	Komisioni diskuton me lidhur ecurinë dhe mënyrën e rregullimit dhe menaxhimit të fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social në Republikën e Kosovës.	Kryetari i Komisionit Stafi mbështetës
Faza e dytë: HARTIMI I KODIT				
Java VIII (Qershor)	Rishikimi i planit të punës së Komisionit.	Ndërtesa e Kuvendit	Komisioni Ad-Hoc si dhe stafi mbështetës përgatit rishikimin e Planit të Punës, i cili miratohet në Komision.	Komisioni Stafi mbështetës
Java IX (Qershor)	Fillimi i hartimit të raportit të punës së Komisionit.	Ndërtesa e Kuvendit	Grupi punues së bashku me stafin mbështetës fillon hartimin e raportit i cili pasqyron konkluzionet e dala nga takimet e Komisionit, evidentimin e sfidave dhe rekomandimet eventuale të marrura nga grupet e interesit.	Komisioni Stafi mbështetës
Java IX (Qershor)	Hartimi i raportit të punës së Komisionit.		Grupi punues dhe stafi mbështetës i komisionit vazhdojnë me hartimin e	Komisioni Stafi mbështetës

			raportit.	
Java IX (Qershor)	Shqyrtimi dhe miratimi i draft raportit në Komision.		Komisioni Ad-Hoc shqyrton dhe miraton raportin e punës.	Komisioni

Stafi mbështetësi i komisionit ad-hoc:

1. Muhamet Bytyqi;
2. Florent Mehmeti;
3. Elfete Alshiqi – Beqiri.

Kryetar i komisionit

Dardan Sejdiu
